



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI**

Nr. 1020 Prot.

Tiranë, më 28.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 140, datë 28.05.2026**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën Nr. 263 regj, datë 12.11.2025, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”<sup>3</sup>, përfaqësuar nga znj. S.L, Drejtore Ekzekutive, kundër Shoqërisë “XH.....-SH” sh.p.k, me Nipt J xxxxxxxxxxxxxL, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara për mosgarantimin e aksesueshmërisë në godinën e Grand Hotel Europa Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër, mungojnë elementët e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, si më poshtë:

- Nuk ka vende parkimi të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.
- Ka një rampë në hyrje, por është shumë e pjerrët dhe e ngushtë, gjë që është shumë e rrezikshme për tu përdorur. Nuk është e përdorshme edhe nëse do të doje sepse nuk përputhet me asnjë standard. Në anë, ka një rampë tjetër, por nuk gjendet lehtë dhe për më tepër nuk ka parrakë dhe e kanë mbyllur derën dhe kanë vendosur tavolina, në anën ku duhet të përdoret rampa. Pra, është jashtë funksionit.
- Trotuaret nuk janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi “Pala ankuese”

- Nuk ka elementë aksesueshmërie për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe përmirësimin e situatës në mënyrë që të jetë e aksesueshme për komunitetin dhe për personat me aftësi të kufizuara.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara për mosgarantimin e aksesueshmërisë në Pallatin e Kulturës, Bashkia Kavajë. Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe*

sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1592/1 prot datë 03.12.2025, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa. Me anë të kësaj shkrese, subjektit i'u kërkua informacion në lidhje me çështjet e mëposhtme:
  - Sa është numri total i vendeve të parkimit dhe sa prej tyre janë të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara?
  - Informacion dhe kopje të dokumentacionit ligjor dhe teknik mbi përmbushjen e standardeve dhe kritereve sipas parashikimeve ligjore në fuqi, që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësinë e kufizuara, në lidhje me rampën/rampat, trotuarët dhe elementët e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Rezulton se subjekti ka marrë dijeni për këtë shkresë, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar Nr. RR807658496AA administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.

2. Me shkresën nr. 15 prot., datë 05.01.2026, Komisioneri i është drejtuar sërish subjektit me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit, për të dërguar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke i sjellë në vëmendjen se mosplotësimi i kësaj kërkesë, përbën shkelje të dispozitave të LMD-së.

Subjekti ka marrë dijeni për shkresën nr. 15 prot., datë 05.01.2026, më datën 06.01.2026, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar me Nr. RR805015998AA, por nuk ka kthyer përgjigje.

3. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, me shkresën nr. 220 prot, datë 27.01.2026, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike në datën 18.02.2026.

Shoqëria "XHENIS-SH" sh.p.k (Grand Hotel Europa, Shkodër) nuk u paraqit në seancë dëgjimore dhe nuk depozitoi informacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ankesës, të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri.

4. Me vendimin nr.53, datë 06.03.2026, Komisioneri vendosi të gjobisë Shoqërinë "XHENIS-SH" sh.p.k/Grand Hotel Europa, Shkodër, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.263, datë 12.11.2025.

5. Me e-mailin datë 12.03.2026, Shoqërinë "XH.....-SH" sh.p.k/Grand Hotel Europa, Shkodër, paraqiti një kërkesë për kundërshtimin e vendimit dhe rishqyrtimin e tij, duke parashtruar ndër të tjera se:

*"Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k, me NIPT JxxxxxxxxxL, administruese e Grand Hotel Europa, Shkodër, pasi është njohur me përmbajtjen e Vendimit nr. 53, datë 06.03.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqet këtë qëndrim zyrtar kundërshtues, si më poshtë:*

*Së pari, shprehim se nuk jemi dakord me konstatimet dhe masën administrative (gjobën) e vendosur, pasi vlerësojmë se ato nuk mbështeten plotësisht në një analizë të plotë të rrethanave faktike dhe ligjore që lidhen me objektin në fjalë.*

*Me datë 11.11.2025 Fondacioni "Së Bashku" ka realizuar një aktivitet për të cilin janë dakordësuar me herët termat dhe kushtet për zhvillimin e aktivitetit provuar kjo edhe sipas faturës me nr.185 datë 31.10.2025. Dakordësimi ka ardhur pasi është verifikuar përshtatshmëria për zhvillimin e aktivitetit i cili ka përfunduar me sukses ku edhe pas përfundimit janë pyetur organizatorët për mbarëvajtjen e aktivitetit të cilët janë shprehur se nuk ka patur asnjë pretendim nga pjesmarësit.*

*Në mbështetje të këtij qëndrimi parashtrojmë sa vijon:*

#### *1. Mungesa e vlerësimit të plotë të rrethanave objektive të ndërtesës*

*Ndërtesa ku ushtron aktivitetin Grand Hotel Europa disponon rampat përkatëse dhe janë totalisht të aksesueshme për personat me aftësi ndryshe. Kjo ndërtesë është një objekt me karakteristikë të veçantë arkitektonike, i cili në shumë raste kufizon mundësinë e ndërhyrjeve strukturore të menjëhershme pa procedura të posaçme miratimi nga autoritetet kompetente. Në këto kushte, çdo ndërhyrje për ndryshime strukturore duhet të realizohet në përputhje me legjislacionin përkatës dhe me miratime institucionale.*

#### *2. Mungesa e qëllimit diskriminues*

*Në kuptim të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", diskriminimi nënkupton trajtim të pabarabartë për shkak të një karakteristike të mbrojtur. Shoqëria jonë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim apo praktikë që synon përjashtimin apo trajtimin e pabarabartë të personave me aftësi të kufizuara.*

*Përkundrazi, subjekti ynë ka qenë dhe mbetet i hapur për të gjithë klientët pa dallim dhe nuk ekziston asnjë praktikë e qëllimshme apo vendimmarrje që synon kufizimin e aksesit të këtij komuniteti.*

### *3. Masat e ndërmarra dhe vullneti për përmirësim*

*Shoqëria jonë ka treguar vullnet të plotë për të përmirësuar kushtet e aksesueshmërisë në ambientet e hotelit, në përputhje me standardet dhe mundësitë teknike që ofron objekti.*

*Çdo përmirësim i mëtejshëm kërkon: projektim teknik të miratuar; ndërhyrje të autorizuara nga institucionet përkatëse; respektimin e rregullave urbanistike dhe të sigurisë së objektit.*

*Në këtë kuadër, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me institucionet përkatëse për të identifikuar zgjidhje teknike të realizueshme.*

### *4. Parimi i proporcionalitetit në vendosjen e sanksionit*

*Vendosja e një mase administrative duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit, duke marrë në konsideratë: rrethanat objektive të rastit; mungesën e qëllimit diskriminues; gadishmërinë e subjektit për përmirësim.*

*Në kushtet kur nuk provohet ekzistenca e një praktike diskriminuese të qëllimshme dhe duke qenë se situata lidhet kryesisht me elementë teknike të ndërtesës, vlerësojmë se masa administrative e vendosur është e pajustificuar dhe joproporcionale.”*

Për sa më sipër, subjekti kërkon:

1. Rishqyrtimin e Vendimit nr. 53, datë 06.03.2026, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimit.
  2. Shfuqizimin e masës administrative (gjobës) ndaj shoqërisë "XH.....-SH" sh.p.k.
  3. Vijimin e bashkëpunimit institucional për të identifikuar zgjidhje të arsyeshme dhe teknikisht të realizueshme për përmirësimin e aksesueshmërisë.
- 
6. Me e-mailin e datës 13.03.2026, pala ankuese paraqiti qëndrimin e saj, duke parashtruar se, subjekti duhet të paraqesë prova konkrete lidhur me synimin për të përmirësuar situatën, duke paraqitur një projekt të miratuar dhe të buxhetuar për përmirësimin e aksesueshmërisë.
  7. Me qëllim vlerësimin e kërkesës së shoqërisë "XH.....-SH" sh.p.k , shkresën nr.611 prot., datë 25.03.2026, Komisioneri kërkoi nga subjekti depozitimin e informacionit të mëposhtëm:
    - Cilat janë karakteristikat e veçanta arkitektonike, të cilat kufizojnë mundësinë e ndërhyrjeve strukturore në ndërtesë për të adresuar aspektet e aksesueshmërisë sipas legjislacionit në fuqi? A ka ndërtesa ndonjë status të veçantë, sipas legjislacionit në fuqi?

- A ka një plan veprimi me masa konkrete me qëllim identifikimin dhe plotësimin e standardeve dhe kriterëve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, afatet kohore dhe fondet e nevojshme për realizimin e tyre?

Në vijim të kësaj kërkesë për informacion, nga ana e shoqërisë "XH.....-SH" sh.p.k nuk pati asnjë përgjigje.

### **III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë**

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Siç u analizua edhe në kuadrin e legjitimitetit të palës ankuese, Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë si organizatë, por paraqet ankesën në mbrojtje të interesit publik dhe kolektiv, pretendime diskriminimi të personave me aftësi të kufizuara për mosgarantimin e aksesueshmërisë në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër, e cila administrohet nga shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k.

Pala ankuese pretendon konkretisht se: nuk ka vende parkimi të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara; rampa e hyrjes kryesore është shumë e pjerrët dhe e ngushtë, nuk përputhet me asnjë standard dhe është e rrezikshme; rampa anësore nuk gjendet lehtë, nuk ka parrakë dhe akses i saj është i bllokuar nga tavolina; trotualet nuk janë të aksesueshme; mungojnë elementët e tjerë të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Për të marrë informacion dhe për të shqyrtuar pretendimet e ngritura nga pala ankuese lidhur me mungesën e aksesueshmërisë në këtë ndërtesë, Komisioneri i'u drejtua Shoqërisë “XH.....-SH” sh.p.k, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa objekt shqyrtimi, duke kërkuar informacion nëse ndërtesa e Grand Hotel Europa, Shkodër, plotëson standardet e aksesueshmërisë, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi. Së bashku me kërkesën për informacion, subjektit i'u vendos në dispozicion kopja e ankesës dhe materialet fotografike të depozituara nga pala ankuese.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria “XH.....SH” sh.p.k, pavarësisht njoftimit të rregullt me shërbim postar, nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë dokumentacion për të provuar se ndërtesa e Grand Hotel Europa, Shkodër, plotëson standardet e aksesueshmërisë. Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k nuk prapësoi asnjë nga pretendimet e palës ankuese dhe pamjet fotografike të paraqitura prej saj. Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k nuk u paraqit as në seancën dëgjimore publike të datës 18.02.2026.

Vetëm pas vendimit nr. 53, datë 06.03.2026, të Komisionerit, për gjobitjen e subjektit me gjobë për mosdhënien e informacionit, Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k paraqiti kundërshtimin e datës 12.03.2026. Në kundërshtimin e saj, subjekti pretendoi ndër të tjera se ndërtesa disponon rampat përkatëse dhe se çdo ndërhyrje strukturore kërkon procedura të posaçme miratimi. Megjithatë, subjekti nuk paraqiti asnjë provë konkrete, dokumentacion teknik, plan veprimi apo projekt të miratuar. Subjekti nuk u përgjigj dhe nuk dërgoi informacionin e kërkuar nga Komisioneri me shkresën nr.611 prot., datë 25.03.2026, në lidhje me arsyet që e kishin pamundësuar për plotësimin e standardeve të aksesueshmërisë dhe planifikimet në vijim për rregullimin e situatës.

### **Kuadri ligjor i zbatueshëm**

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>4</sup>, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por ka përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i Konventës është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (Neni1, i Konventës).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, KDPAK vendos mbi shtetet detyrimin për të marrë masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambientet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe

---

<sup>4</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

barrierave, zbatohen ndër të tjera për, ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: *“2. Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;...”*

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”* (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: *“9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.”*

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: *“Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve*”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: *“3. “Pengesat” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastruktorore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”*

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve është një nga parimet e këtij ligji (neni 3/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: *“1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social,*

*arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.”*

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave, ka miratuar vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “*Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara*”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohej pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështrësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të Kreut 2, të VKM Nr. 1074/2015, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në Vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008/Rregullorja)*. Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

#### *“PJESA I*

*Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike*

#### *Kreu I*

*Të përgjithshme*

#### *Neni 1*

*Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit*

*1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.*

*2. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*

*3. Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:*

*- të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;*

- godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;
- ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;
- ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.

## Neni 2

### *Përshtatja e objekteve ekzistuese*

1. Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe te llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.
2. Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.
3. Në objektet e banimit publike/privat dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.
4. Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.

## Neni 3

“19. Përpunimi relievor - është përpunimi përfundimtar me reliev i sipërfaqes së ecjes.

20. Vija relievore drejtuese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes e dedikuar për drejtim të lëvizjes së personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar, e cila në fund të rrugës dhe në vendin e ndërrimit të drejtimit të lëvizjes përcakton atë me ndërrimin e strukturës relievore me gjerësi së paku 40 cm.

21. Vija relievore paralajmëruese - është përpunim me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila vendoset me qëllim të paralajmërimit të personave që nuk shohin dhe/ose me shikim të dobësuar për rrezikun nga komunikacioni.

22. Fusha relievore paralajmëruese - është përpunimi me reliev i sipërfaqes së ecjes, e cila shërben për paralajmërim të personave që nuk shikojnë dhe/ose me shikim të dobësuar të ndryshimit të nivelit të lëvizjes.”

Në nenet 18 dhe 19, të Pjesës së Parë të Rregullores, parashikohet se, hapësirat e jashtme të ndërtesës dhe elementet përbërëse të tyre, si dhe sinjalistika, duhet të jenë të përshtatura sipas specifikimeve të parashikuara nga dispozitat respektive të rregullores (pikat 2 të nenit 4 dhe standardet e pikës 2 të nenit 8 të Pjesës së Dytë të kësaj Rregulloreje dhe rregullat e pikës 3 të

nenit 4 të Pjesës së Dytë të kësaj Rregulloreje), në mënyrë që të mund të jenë të arritshme nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Sipas nenit 9, të Pjesës së Parë të Rregullores, përcaktohen rregulla të posaçme për shkallët dhe platformat, të cilat duhet të jenë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga neni 4, pikat 1.10 dhe 1.11 dhe pikat 2.10 dhe 2.11, të nenit 8, të Pjesës së Dytë të Rregullores.

Sipas neni 17, i cili ka të bëjë me njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre si dyert, dyshemetë, kornizat e jashtme, orenditë fikse, terminalët e impianteve, shërbimet higjienike, ballkonet, tarracat, kalimet horizontale, shkallët, platformat, ashensorët, shkallët e shërbimit, platformat ngritëse, etj, vlejnjë rregullat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 4, dhe standardet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 8, të Pjesës së Dytë të kësaj Rregulloreje.

Në Pjesën e Dytë të Rregullores, përcaktohen rregullat teknike dhe standardet për garantimin e mundësisë së hyrjes, përshtatshmërisë dhe fushpamjes në ndërtesa. Disa nga parashikimet e kësaj pjesë të rregullores janë si më poshtë:

#### *“Kreu I*

##### *Të Përgjithshme*

#### *Neni 1*

##### *Fusha e aplikimit*

*Rregullat e përfshira më poshtë aplikohen në:*

- ndërtesat private që ndërtohen të reja, rezidenciale ose jo;*
- ndërtesat rezidenciale publike të financuara nga buxheti i shtetit, që ndërtohen të reja;*
- ristrukturimet e ndërtesave private dhe publike;*
- hapësirat e jashtme të ndërtesave të lartpërmendura në zonat e përcaktuara.*

#### *Kreu III*

##### *Zbatimi i rregullave*

#### *Neni 7*

##### *Zbatimi dhe shmangia nga rregullat*

*1. Standardet që përmban neni 8 në pjesën e dytë të kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Zgjidhjet teknike që përcaktohen në neni 9 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje edhe pse nuk mbështeten në standardet e dhëna në këtë rregullore, janë të pranueshme nëse u përgjigjen kriterëve të projektimit të cilat plotësojnë rregullat nëpërmjet reduktimit të dimensioneve me zgjidhje të veçanta hapësinore ose teknologjike.*

*2. Në projekt propozohen zgjidhje alternative për specifikimet dhe zgjidhjet teknike, që i përgjigjen kriterëve të projektimit. Në këtë rastë çdo ndryshim duhet shoqëruar nga relacioni i ilustruar me grafikët e nevojshëm për të treguar alternativën e propozuar dhe ekuivalentin ose cilësinë më të mirë të rezultateve që rrjedhin nga zbatimi i tyre.*

3. Përputhshmëria e projektit me rregullat dhe standardet e dhëna në rregulloren e miratuar me këtë vendim dhe përshtatshmëria e zgjidhjeve të mundshme alternative certifikohen nga profesionistë të përgatitur pranë zyrave të kontrollit të projektit.

4. Rregullat dhe standardet e këtij vendimi, janë të shmangshme vetëm për ndërtesat ose pjesë të tyre, të cilat në respektim të rregullave teknike specifike, nuk mund të realizohen pa pengesa arkitektonike, ose për vende të posaçme teknike në të cilat hyrja u rezervohet vetëm personave të specializuar.

5. Në ndërhyrjet e ristrukturimit, lejohen shmangiet në rastin e pamundësisë teknike në lidhje me elementet strukturore dhe të impianteve, të cilat vërtetohen paraprakisht. Shmangiet lejohen vetëm nga autoritetet kompetente, përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.”

Në nenin 4, të Pjesës së Dytë të Rregullores, përcaktohen në mënyrë të detajuar kriteret e projektimit për arritshmërinë, për njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tij si dhe hapësirat e jashtme. Ndërsa në Kreun IV, të Pjesës së Dytë, të Rregullores, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t’u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e hyrjes dhe përshtatshmërinë e ndërtesave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Konkretisht në nenin 8, të kësaj Rregulloreje, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në ndërtesa, të detyrueshme për t’u respektuar. Në pikat 2.1, 2.6, 2.9, 2.11 dhe 3.3, të nenit 8 të Rregullores, parashikohet :

*"2. Njësitë e mjedisit dhe përbërësit e tyre:*

*2.1 Dyert, hapësirat e dyerve të hyrjes së çdo ndërtese dhe të çdo njësie të patundshme duhet të jenë të paktën 80 cm. Hapësira e dyerve të tjera duhet të jetë të paktën 75 cm. Hapësirat para dhe pas derës duhet të jenë në përputhje me minimumin e parashikuar në skemat grafike të dhëna figura 2 shtojca B. Lartësia e dorezave duhet të jetë midis 85 dhe 95 cm (e këshillueshme 90 cm)..."*

*"2.6 Shërbimet higjienike duhet të garantojnë manovrimin dhe përdorimin e pajisjeve të personave me aftësi të kufizuara motorike, duhet të parashikojnë afrim anësor te ËC-ja, bideja, vaska, dushi, lavatriçja dhe afrim ballor te lavamani..."*

*"2.9 Rrugët horizontale dhe korridoret duhet të kenë një gjerësi minimale 100 cm, dhe zgjerime të përshtatshme për të lejuar ndryshimin e drejtimit të lëvizjes nga ana e personit në karrige me rrota..."*

*"2.11 Platformat e pjerrëta (rampat) — Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës. Rampa duhet të plotësojë kushtet: pjerrësi të lejuar deri në 1:20 (5%); gjerësi së paku 120 cm në hapësirat e jashtme; shesh pushime horizontale me dimensione minimale prej 150 x 150 cm; sipërfaqe relievore kundër rrëshqitëse; rrethim të ndërtuar me dorëza mbajtëse në dy lartësi — prej 60 cm dhe 90 cm..."*

3.3 Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi jo më të vogël se 320 cm dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuara. Të ashtuquajtura vende makinash, të sinjalizuara, caktohen në ngjitje të vendkalimeve të këmbësorëve dhe në afërsi të hyrjes së ndërtesave ose paisjeve. Me qëllim lehtësimin e transferimit të personit në karrige me rrota në kushte të njëjta atmosferike, preferohet që vendet e makinave të rezervuara të jenë të pajisura me mbulesë. Vendparkimi për PAK duhet të vendoset afër hyrjes së ndërtesës. Vendparkimi për automjete, kur parkimi bëhet pjerrtas apo për së gjati në raport me trotuarin për këmbësorët, madhësia e tij duhet të jetë 370 x 500 cm, figura 32 shtojca B. Nëse vendparkimi është për dy makina madhësia e tij duhet të jetë 590 x 500 cm me distancë ndërmjet tyre 150 cm, figura 33 shtojca B. Dalja nga vendparkimi dhe hyrja në trotuarët e këmbësorëve kryhet me një pjerrësi 10% dhe gjerësi 120 cm."

Sipas nenit 18, të pjesës së dytë, të Rregullores, ndërtesat duhet të jenë të pajisura me një plan orientues, sipas kriterëve të posaçme të parashikuara nga kjo dispozitë.

"Neni 18

#### **Plani orientues për lëvizje në ndërtesa**

Plani orientues për lëvizje në ndërtesë duhet të jetë i realizuar në formë relievore dhe të plotësoj kushtet në vijim:

- të jetë i vendosur horizontalisht deri në 90 cm lartësi dhe vertikalisht deri në 180 cm lartësi nga kuota e dyshemesë;
- të jetë i vendosur pranë hyrjes së ndërtesës;
- të përmbajë informacion në shkrimin Braille;
- prej derës hyrëse të ndërtesës deri te plani të ketë vij relievore drejtuese në kahje të lëvizjes;
- të tregohet drejtimi për t'a arritur me shenjën figura 1.2 dhe 1.3."

Referuar nenit 19, përcaktohet se: "2. Tabelat e lajmërimeve duhet të vendoset në lartësi prej 120 deri 160 cm. Ato tregohen me shenjë arritshmërisë sipas fig. 1.24 të shtojcës A."

Në nenin 26 "Vendparkimet", të kapitullit V, "Rregullat përfundimtare" përcaktohet: "Në parkimet dhe garazhet publike, si dhe pranë objekteve ndërtimore 5% e vendeve përshtaten në raport me numrin total të vend parkimeve, por jo me pak se një."

Referuar aktivitetit të Shoqërisë "XHENIS-SH" sh.p.k si strukturë pritëse dhe hotelerie, në rastin konkret zbatohen dispozitat e pikës 1, të nenit 30 të Rregullores, të cilat parashikojnë kërkesat specifike për objektet e shërbimeve tregtare, hotelerie dhe turistike, si vijon:

"Neni 30, pika 1

Objektet për shërbime tregtare, hotelerie dhe turistike:

*nenet: 8 (pikat 2.1, 2.9, 2.6 ose 13), 10 dhe 19 pika 2 për hotele me 50 e më shumë dhoma (dhoma/ËC);*

*nenet: 8 (pikat 2.1, 2.9, 2.6 ose 13), 10 dhe 19 pika 2 për hotele me 50 e më shumë dhoma me njësi sanitare të përbashkët;*

*nenet: 8 (pikat 2.1, 2.9, 2.6) dhe 11 për bare dhe restorante me 80 dhe më shumë vende;*

*neni: 8 (pikat 2.1, dhe 2.9) për qendra informacioni turistik."*

Sipas nenit 5, pika 3, të Pjesës së Dytë të Rregullores, strukturat pritëse si hotele, fshatra turistike, kampingje etj., duhet të kenë të gjitha pjesët dhe shërbimet e përbashkëta si edhe një numër të përcaktuar dhomash të arritshme edhe nga personat me aftësi të kufizuara. Numri i dhomave të arritshme duhet të jetë të paktën dy (2) në 40 dhoma, ose duke shtuar dy dhoma të tjera mbi 40 dhoma. Vendndodhja e dhomave të arritshme preferohet të jetë në katet e ulëta të ndërtesës.

Sipas nenit 11, të Pjesës së Dytë të Rregullores, ambientet e shërbimit si bar dhe restorant, duhet të kenë: kalim të sigurtë ndërmjet tavolinave me gjerësi të paktën 100 cm për minimum 20% të sipërfaqes shfrytëzueshme; banak dhe tavolina me sipërfaqen e sipërme në lartësi 85 cm, me gjerësi minimale 70 cm dhe thellësi afrimi 50 cm; muret, dyshemetë dhe dyert të realizuara me nuanca ngjyrash në kontrast; dyert dhe muret ndarëse me sipërfaqe xhami të shënuara dukshëm.

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, të cilat duhet të përmbushin ndërtesat që shërbejnë si hotele dhe struktura pritëse, sikurse është në rastin objekt shqyrtimi ndërtesa e Grand Hotel Europa, Shkodër, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Meqenëse aktiviteti ushtrohet nga një person juridik privat që ofron shërbime për publikun, detyrimi për respektimin e standardeve të aksesueshmërisë shtrihet plotësisht edhe mbi Shoqërinë "XH.....-SH" sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k nuk provoi se ndërtesa e Grand Hotel Europa, Shkodër, plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me parashikimet e mësipërme ligjore.

Duke mbajtur në konsideratë diversitetin e personave me aftësi të kufizuar, edhe nevojat e tyre për të siguruar aksesueshmërinë janë të ndryshme. Kështu, vendosja e një rampe nuk eliminon të gjitha pengesat/barrierat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuar. Rampa e paraqitur nga subjekti si element aksesueshmërie nuk u provua se plotëson standardet teknike të detyrueshme të parashikuara nga VKM nr. 1503/2008, pjerrësinë maksimale të lejuar (5%), gjerësinë minimale (120 cm në hapësirat e jashtme), parrakët mbajtës, shesh pushimet dhe sipërfaqen kundër rrëshqitjes.

Bazuar në konstatimet e mësipërme si dhe referuar standardeve dhe kriterëve teknike të parashikuara nga VKM nr. 1503/2008, për ndërtesat ku ofrohen shërbime hoteliere dhe turistike, Grand Hotel Europa, Shkodër, nuk rezultoi se plotëson kushtet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

Garantimi i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sikurse më sipër rezulton, kërkon aplikimin e një sërë standardesh dhe kriteresh teknike, të cilat janë miratuar me VKM nr. 1503/2008. Është respektimi i këtyre standardeve dhe kriterëve teknike, në tërësinë e tyre, që mundëson heqjen e barrierave/pengesave për personat me aftësi të kufizuara dhe mundëson që personat me aftësi të kufizuar të kenë akses në shërbimet hoteliere në baza të barabarta me të tjerët. Ekzistenca e pengesave/barrierave infrastrukurore në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër, sjell si pasojë që personave me aftësi të kufizuara t'ju mohohet akses i barabartë në këtë strukturë pritëse.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ndërtesa e Grand Hotel Europa, Shkodër, nuk përmbush standardet teknike të miratuara për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar, e për rrjedhojë Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k nuk ka përmbushur detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Meqenëse aksesueshmëria, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuar të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, Komisioneri vlerëson se dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në raport me personat e tjerë.

## **B. Shkaku i mbrojtur**

Pala ankuese pretendon diskriminim të personave me aftësi të kufizuar për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në ndërtesën e Grand Hotel Europa Shkodër, që administrohet nga shoqëria XHENIS-SH sh.p.k.

Në nenin 1, të LMD, përcaktohet se: ***“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”***.

Referuar nenit 1, të LMD, shkaku i diskriminimit *“aftësia e kufizuar”* i pretenduar nga pala ankuese, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë shkakun e mbrojtur**

KDPAK parashikon në nenin 9, të saj, të drejtën për aksesueshmëri si një të drejtë më vete, përpos parashikimit të aksesueshmërisë si një nga parimet mbi bazën e të cilit duhet të interpretohen të gjithë të drejtat e tjera për personat me aftësi të kufizuara. Neni 9, i KDPAK vendos mbi shtetet detyrimin për të marrë masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët.

KDPAK, sanksionon në nenin 30 të saj, të drejtën e personave me aftësi të kufizuar në bazë të barabartë me të tjerët për të marrë pjesë në jetën kulturore, argëtim, kohën e lirë dhe sport. Për të siguruar këtë të drejtë, KDPAK ngarkon shtetet me detyrimin për të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë akses në shërbime dhe hapësirat publike (neni 30/1/c KDPAK). Kjo e drejtë lidhet drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë hoteliere si shërbim i hapur për publikun.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”*.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit

ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>5</sup>. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>6</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>7</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>8</sup>.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, "diskriminimi" përkufizohet si: *"çdo dallim, përrjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura"*. Rrjedhimisht, sipas LMD, diskriminimi mund të ndodh edhe pa pasur qëllim diskriminues nga ana e subjektit, mjafton që pasoja e sjelljes të jetë trajtimi i pabarabartë dhe i pafavorshëm i personave me aftësi të kufizuara. Fakti i pretenduar nga subjekti se nuk ka pasur qëllim diskriminues, nuk e përjashton automatikisht ekzistencën e diskriminimit, nëse pasoja e mungesës së aksesueshmërisë është mohimi i aksesit të barabartë për personat me aftësi të kufizuara.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton: *"Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi"*.

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht, në nenin 20, pika 1, dhe pika 2, geramat "a" dhe "ë", të LMD parashikohet: *"1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo*

<sup>5</sup> Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>6</sup> Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>7</sup>Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>8</sup> Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

*shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku;... ë) lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim.”, Grand Hotel Europa, Shkodër, si strukturë hotelerie e hapur për publikun, i nënshtrohet plotësisht këtyre dispozitave.*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*. Të njëjtin rregullim, në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>9</sup>

Bazuar në faktet dhe provat e administruara, si dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, rezultoi e provuar se, Grand Hotel Europa, Shkodër, nuk përmbush standardet e miratuara për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Dështimi për të përmbushur standardet teknike të miratuara me qëllim sigurimin e aksesueshmërisë, i ekspozon personat me aftësi të kufizuara ndaj një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, personat me aftësi të kufizuara, trajtohen në mënyrë më pak të favorshme, pasi mospërmbushja e standardeve teknike i vendos ata përpara pengesave dhe barrierave, në raport me pjesën tjetër të personave që nuk kanë aftësi të kufizuara.

Pretendimi i subjektit se nuk ka pasur qëllim diskriminues nuk e përjashton nga përgjegjësia ligjore. Siç rezultoi nga përkufizimi i nenit 3, pika 1, të LMD, diskriminimi ndodh edhe kur pasoja e sjelljes, jo vetëm qëllimi, është trajtimi i pabarabartë. Mungesa e aksesueshmërisë,

<sup>9</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

pavarësisht nga ekzistenca apo jo e qëllimit diskriminues, sjell si pasojë faktike mohimin e aksesit të barabartë të personave me aftësi të kufizuara në shërbimin e hotelit. Sa më sipër, argumenti i subjektit lidhur me “mungesën e qëllimit diskriminues” nuk përbën justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur, që në rastin konkret është aftësia e kufizuar, dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara, për shkak të mosrespektimit të standardeve të aksesueshmërisë, të miratuar nga aktet në fuqi si më sipër janë cituar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pra të diskriminimit *prima facie*. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k kishte barrën e provës që të provonte se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Aksesueshmëria është një parakusht për gëzimin efektiv të të drejtave të ndryshme nga personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë sipas KDPAK, sigurimi i aksesueshmërisë arrihet përmes realizimit progresiv.

Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, i miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, përcakton se: “*Si minimum, situatat e mëposhtme në të cilat mungesa e aksesit ka penguar një person me aftësi të kufizuara të ketë akses në një shërbim ose objekt të hapur për publikun, duhet të konsiderohen si akte të ndaluara të diskriminimit të bazuar në aftësinë e kufizuar: (a) Kur shërbimi ose objekti është krijuar pasi janë prezantuar standardet përkatëse të aksesueshmërisë; (b) Aty ku aksesit mund të ishte dhënë në objekt ose shërbim (kur ai u krijua) nëpërmjet përshtatjes së arsyeshme.....”.*

Kjo qasje parashikohet edhe në nenin 4, të ligjit nr. 93/2014, në bazë të të cilit është miratuar VKM nr. 1074/2015. Në këtë VKM, parashikohet se planifikimi për realizimin e përshtatjes do të realizohet në mënyrë progresive (Kreu I, pika 12). VKM nr. 1074/2015 vijon më tej duke parashikuar në pikat 9, 10 dhe 13 se: “9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi. 10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për: a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria; b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen; c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë. 13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.”

Realizimi progresiv do të thotë që heqja e pengesave dhe sigurimi i aksesueshmërisë duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, por në çdo rast në mënyrë të qëndrueshme, efektive dhe brenda një kornize afatshkurtër dhe afatmesme.

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

*“.....25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për përshtatjen e arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.*

*26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshme është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Përshtatja e arsyeshme mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një person me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.*

GJEDNJ në jurisprudencën e saj, lidhur me diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara, ka mbajtur qëndrimin se: “*duke pasur parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të nxitur pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, marzhi i vlerësimit që gëzojnë shtetet në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është ndjeshëm i reduktuar<sup>10</sup> dhe se për shkak të cenueshmërisë së veçantë të personave me aftësi të kufizuara, një trajtim i tillë do të kërkonte arsye shumë të rëndësishme për t'u justifikuar<sup>11</sup>.*”

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me faktin se kur është ndërtuar ndërtesa e Grand Hotel Europa, Shkodër. Standardet e aksesueshmërisë janë vendosur dhe miratuar që prej vitit 2008, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2008. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, edhe nëse ndërtesa e Grand Hotel Europa është ndërtuar përpara miratimit të standardeve të aksesueshmërisë (VKM nr. 1503/2008), që prej momentit kur janë bërë të detyrueshme standardet e aksesueshmërisë dhe

<sup>10</sup> Shih: *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, prg. 84, GJEDNJ 2009.

<sup>11</sup> Shih: *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, 73, GJEDNJ 2016.

deri në momentin e paraqitjes së ankesës, ka kaluar një kohë e gjatë e pajustificuar, gjatë të cilës Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k ka dështuar që të sigurojë aksesueshmërinë e kësaj ndërtese. Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm që e ka pamundësuar atë për të garantuar aksesueshmërinë. Ndërsa, nëse ndërtesa është ndërtuar pas vitit 2008, çdo godinë e ndërtuar pas këtij viti, ka patur detyrimin që të ndërtohet në përputhje me standardet e përcaktuara nga VKM nr. 1503, datë 19.11.2008.

Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k nuk vendosi në dispozicion asnjë informacion në lidhje me hartimin e një plani veprimi, me afate kohore dhe fonde të përcaktuara, për eliminimin e barrierave infrastrukture/arkitektonike dhe sigurimin e standardeve dhe kriterëve teknike të aksesueshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër.

Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k nuk vuri në dispozicion asnjë informacion në lidhje me evidentimin e pengesave ekzistuese, planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe afatin kohor për realizimin e përshtatshmërisë. Komisioneri vlerëson se, nga ana e subjektit nuk janë marrë masa për të punuar drejt realizimit gradual të aksesit universal, brenda kufijve të buxhetit në dispozicion.

Duke mbajtur në konsideratë gjithë sa më sipër, Komisioneri konstaton se, Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k, në mënyrë të pajustificuar, nuk ka ndërmarrë masa për heqjen e pengesave infrastrukture/arkitektonike dhe sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mosplotësimi i standardeve të aksesueshmërisë në Grand Hotel Europa, Shkodër, ka sjellë mohim të aksesit për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, dhe se Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k nuk arriti të provojë se ka marrë masat e duhura për të realizuar në mënyrë progresive aksesueshmërinë në këtë ndërtesë.

Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk ka asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të cilit i janë nënshtruar personat me aftësi të kufizuara, dhe rrjedhimisht trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm i personave me aftësi të kufizuara si pasojë e mungesës së aksesueshmërisë së ndërtesës së Grand Hotel Europa, Shkodër, përbën diskriminim sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*", ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të LMD, përcaktohet: "*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*".

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit. LMD,

nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar sjellje diskriminuese ndaj komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, pasi rezultoi se Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k nuk ka marrë masa për të siguruar aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara në Grand Hotel Europa, Shkodër. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit dhe garantimit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas standardeve të miratuara dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara nga ana e Shoqërisë “XH.....-SH” sh.p.k, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër.
2. Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k, duhet të marrë masa konkrete për të siguruar aksesueshmërinë në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
3. Shoqëria “XH.....-SH” sh.p.k, duhet të hartojë dhe të depozitojë pranë Komisionerit, një plan masash konkret për evidentimin dhe adresimin e të gjitha pengesave të aksesueshmërisë në ndërtesën e Grand Hotel Europa, Shkodër. Plani duhet të përmbajë planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimin e afateve kohore konkrete për realizimin e aksesueshmërisë.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Shoqëria "XH.....-SH" sh.p.k, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**

Shkaku: Aftësia e kufizuar  
Fusha: Të mira dhe shërbime/Aksesueshmëri  
Lloji i vendimit: Diskriminim